



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.499/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Afijete Sada – Gllogjani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Kushtrim Zuka, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Demokratike e Kosovës, të paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa Anr.499/2021, e datës 14.02.2021, e paraqitur nga Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të vazhdimit të sponsorimit të fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, në ditën e heshtjes zgjedhore. Ndërsa subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje i Shqiptohet gjobë, në lartësi prej 500 (pesëqind euro), dhe detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënimin e dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Paneli, ka pranuar ankesën: Anr.499/2021, e datës 14.02.2021, të paraqitura nga Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të vazhdimit të sponsorimit të fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, në ditën e heshtjes zgjedhore, ku gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, ku asambleisti i subjektit LVV në Komunën e Prishtinës, Egzon Azemi, ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë shpërndarjen dhe postimin e një (1) thirrje në rrjetin e tij social Facebook. Kështu duke aluduar në numrin 127 dhe slloganin e Lëvizjes Vetëvendosje, dhe duke mbajtur në cover numrin 127, numër me të cilin ka garuar subjekti i tij. Me këtë rast pretendohet se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të pranohet si e bazuar.

Në përgjigjet në ankesë subjekti politik LVV thekson se ankesa Anr. 499/2021 deklaroj se ankesa për thyerjen e heshtjes zgjedhore duhet të paraqitet para mbylljes së qendrave të votimit, që do të thotë para orës 19:00. Ankesa e PDK-së është paraqitur pasi janë mbyllur qendrat e votimit dhe pasi ka kaluar heshtja zgjedhore, andaj si e tillë është e pasafatshme. Parashtruesi i përgjigjes i prozpozon PZAP-it të nxjerrë vendim me të cilin hedhë poshtë si të pa aftashme ankesën numër Anr.499/2021.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale – fotografive të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës shihet se asambleisti i subjektit LVV në Komunën e Prishtinës, Egzon Azemi, ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë një postim një foto në rrjetin social Facebook, duke aluduar të votohet numri 127 gjithashtu duke përmendur slloganin e Lëvizjes Vetëvendosje, dhe duke mbajtur në cover numrin 127, numër me të cilin ka garuar ky subjekt politik, veprim ky i cili është në kundërshtim me nenin 36, paragrafi 1, pika b, të LZP-së, si dhe nenin 8 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së me të cilin ka bërë promovimin e subjektit politik LVV, ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë se ankesa e paraqitur është e pasafatshme sepse kjo ankesë është paraqitur brenda afatit ligjor, përkatisisht kjo ankese është paraqitur me datë 14.02.2021.

Andaj PZAP, duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se LVV, është përgjegjëse për veprimet e tyre, pasi që me veprimet e lartcekura ka shkelur nenin 36, paragrafi 1, pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se kemi të bëjmë me shkeljen nga mbështetesi
- Faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba PDK ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme,
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet që bien ndesh me rregullativën ligjore, që te mos cenohet heshtja zgjedhore duke siguruar klimë të qetë dhe të përshtatshme për votim të lirë si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: " 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t'ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.", ashtu siç është vendosur si në të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.499/2021 më datë 16.02.2021

Kryesues i Panelit
Ferki Xhafi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.